



BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt. 15.11.2022]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PARAPRAK)

Drejtuar: OPERATORIT EKONOMIK “EKM Konstruksion & Teknologji” shpk
ADRESA: TIRANE ZK 8260 ME NR. PASURIE 2/163, VOL 33 FQ.236 ME ADRESE NE
QYTETIN E TIRANE RRUGA IRFAN TOMINI, SHKOLLA 0

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse në funksion të realizimit të veprave të artit” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit ”Tirana” **me Nr. reference REF-47691-10-27-2022** për nevoja të organit delegates/përfitues “Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit”Tirana”.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 149 datë 31 Tetor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik “EKM Konstruksion & Teknologji” sh.p.k, NIPT M02403014N**

Vlera e ofertës pa tvsh = 1.549.800 (një milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind) lekë.

- **Operatori Ekonomik “MUÇA” sh.p.k, NIPT K01421002H**

Vlera e ofertës pa TVSH– 1.476.600 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë.

Nga pjesëmarrësit është s’kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “MUÇA” sh.p.k, NIPT K01421002H**

Për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i kërkoi ofertuesit të kualifikuar, i pari “Muça” shpk dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

Për sa më sipër Operatori ekonomik “Muça” shpk në dt 14.11.2022 me anë të shkresës hyrëse Nr.40219 Prot ka depozituar pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë dokumentacionin e kërkuar, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse në funksion të realizimit të veprave të artit” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit ”Tirana” me Nr. REF: 47691-10-27-2022. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi u njoh me dokumentacionin e dorëzuar pranë AK bëri verifikimin e të gjithë dokumentacionit dhe konkludoi se dokumentacioni fizik nuk është i plotë pas reflekton mangësitë si më poshtë vijon:

1. **ISO 9001:2015 (ose e përditësuar)** është paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
2. **ISO 14001:2015, (ose e përditësuar)** është paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
3. Kontratat e ngjashme dhe faturat tatimore përkatëse për vërtetimin e përvojës së duhur janë paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
4. Bilancet për vitet 2020 dhe 2021 janë paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
5. Vërtetim Debie lëshuar nga OSSHE është edhe kjo fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
6. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nr 17 dt 20.09.2022 dhe Nr 7 dt 14.07.2022 është paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.
7. Vërtetimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjithashtu është paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Në dt 11.11.2022 me anë të shkresës Nr.35689/5 prot operatori ekonomik “Muça” shpk është vënë në dijeni për të paraqitur dokumentacionin provues për vetdeklarimin si edhe të gjithë dokumentacionin tjetër teknik ekonomik edhe ligjor të paraqitur në sistemin elektronik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave paraqitjen e dokumentacionit sa më sipër cituar e ka kërkuar konform përcaktimeve të bëra në nenin 82 pika 5 gërma (a) dhe në mbështetje të nenit 26 pika 6 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. **Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike”.*

Pra sikundër vihet re edhe në përcaktimin e dispozitës si më sipërshënuar operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë e ka të detyrueshme paraqitjen e dokumentacionit fizik **origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin** përcaktim ky i reflektuar edhe në shkresën me Nr. 35689/5 prot dt 11.11.2022.

Referuar sa më sipër Operatori ekonomik “Muça” shpk ka vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore sa më sipërcituar.

Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të s’kualifikojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” shpk **pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“EKM Konstruksion & Teknologji” shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1.549.800 (një milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.
